



VENDIM

Nr. 31, Datë 09.03.2016

MBI

**FILLIMIN E PROCEDURAVE PËR LICENSIMIN E SHOQËRISË
“BALLENJA POWER MARTANESH”SH.P.K., NË AKTIVITETIN E
FURNIZIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE**

Në mbështetje të neneve 16; 37, pika 2 gërma “ç” dhe 110 të Ligjit Nr. 43/2015 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”, neneve 4, pika 1, gërma “f”; 5, pika 1 gërma “f”; 10 pika 3 të “Rregullores për Procedurat e Liçensimit, Modifikimit, Transferimit të Plotë/Pjesshëm dhe Rinovimit të Liçensave”, të miratuar me Vendimin e Bordit të ERE-s, Nr. 108, datë 09.09.2008 dhe nenit 18 pika 1 gërma “a” e Rregullave të Praktikës dhe Procedurave të ERE-s, miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s nr. 21 datë 18.03.2009, te ndryshuar, Bordi i Entit Rregullator të Energjisë (E.R.E), në mbledhjen e tij të datës 09.03.2016, mbasi shqyrtoi aplikimin e paraqitur nga shoqëria “BALLENJA POWER MARTANESH” sh.p.k., si dhe relacionin e Drejtorisë së Liçensimit dhe Monitorimit të Tregut për liçensimin në aktivitetin e furnizimit të energjisë elektrike të kësaj shoqërie nga Hec “Ballenja”,

Konstatohet se :

Aplikimi i shoqërisë “BALLENJA POWER MARTANESH” sh.p.k., plotëson tërësisht kërkesat e parashikuara nga ERE në “Rregulloren për procedurat e liçensimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të liçensave” si më poshtë:

- Formati i aplikimit (neni 9, pika 1) është plotësuar në mënyrë korrekte;
- Dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor (neni 9, pika 2) është plotësuar në mënyrë korrekte;
- Dokumentacioni financiar dhe fiskal (neni 9, pika 3) është plotësuar në mënyrë korrekte;

- Dokumentacioni teknik për aktivitetin e furnizuesit të energjisë elektrike (neni 9, pikat 4/9 gërma ‘a’, gërma ‘b’ dhe gërma ‘c’ është plotësuar në mënyrë korrekte.

Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i ERE-s,

Vendosi:

1. Të fillojë procedurat për licensimin e shoqërisë “BALLENJA POWER MARTANESH” sh.p.k., në aktivitetin e furnizimit të energjisë elektrike nga Hec “Ballenja”.
2. Drejtoria e Liçensimit, Monitorimit të Tregut dhe të të Licensuarve të njoftojë aplikuesin për Vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë
Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.